

Financat Vendore gjatë periudhës Janar - Mars 2024


Procesi i menaxhimit të financave publike në nivel vendor pas miratimit të Ligjit nr. 68 datë 27.04.2018 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ka hyrë në një fazë të re konsolidimi. Në këtë kuadër Ministria e Financave ndjek vazhdimisht treguesit e të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit vendor me qëllim monitorimin dhe asistencën e njësisve të vetëqeverisjes vendore për përmirësimin e këtij procesi. Referuar të dhënave të Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë dhe treguesve fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar, është realizuar analiza e ecurisë së të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit vendor në nivel kombëtar për periudhën janar-mars 2024.

Të ardhurat vendore

Bazuar në të dhënat e treguesve fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar për 3 mujorin e parë të vitit 2024, njësitë e vetëqeverisjes vendore në shkallë kombëtare kanë mbledhur të ardhura në masën 7,064 milionë lekë, ose krahasuar me planin e vitit 2024 prej 29,114 milionë lekë, të ardhurat faktike të tre mujorit 2024 zënë 24.2 përqind të planit vjetor. Referuar të dhënave për 3 mujorin e vitit 2024 në krahasim me të dhënat e treguesve fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar për vitin 2023, ku janë mbledhur rreth 5,070 milion lekë rezulton se për të njëjtën periudhë në 2024 janë mbledhur 1,994 milion lekë të ardhura më shumë, ose shprehur në përqindje një realizim rreth 39 përqind më i lartë. Këto efekte pozitive në të ardhurat vendore për 3 mujorin e parë të vitit 2024 tregojnë se buxheti vendor është në rritje sa i përket mbledhjes së të ardhurave në shkallë kombëtare.

Duke ju referuar të dhënave të treguesve fiskalë, nëse marrim në analizë të ardhurat e pushtetit vendor për periudhën 3 mujore në vitet 2014-2024, do të kemi rezultatet si në grafikun e mëposhtëm:


Grafiku 1: Të ardhurat e përgjithshme të pushtetit vendor dhe ritmi i rritjes së tyre



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Ndër vite të ardhurat e pushtetit vendor kanë pësuar ndryshime si në vlerë ashtu edhe në strukturën e burimit të tyre. Nga të dhënat e gjeneruara vërejmë se për 3 mujorin e vitit 2024 kemi një përmirësim të ndjeshëm të mbledhjes së të ardhurave krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ashtu siç u theksua edhe më sipër, ku nga të dhënat vërejmë një rritje në mbledhjen e taksave lokale me 44% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023. Duke marrë në analizë të ardhurat e NJVQV-ve sipas burimit, situata paraqitet si në grafikun e mëposhtëm:

Grafiku 2: Të ardhurat sipas burimit për pushtetin vendor në shkallë kombëtare




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Taksat Lokale

Njësitë e vetëqeverisjes vendore gjithmonë e më shumë po konsolidohen në këndvështimin financiar dhe këtë e dëshmon rritja e të ardhurave në përgjithësi dhe sidomos nga taksa lokale. Në këtë këndvështrim Të ardhurat nga taksat lokale, si një ndër burimet më të rëndësishme të financimit të të burimeve të pushtetit vendor, kanë konsoliduar trendin në rritje nga viti në vit pas reformës administrativo-territoriale. Për 3 mujorin 2024 këto taksa janë mbledhur në vlerën rreth 5,793 milion lekë, me rreth 1,763 milion lekë më shumë se një vit më parë ose ndryshe rreth 44% rritje në raport me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Të ardhurat nga taksat lokale zënë pjesën më të madhe ose 82 përqind të totalit të të ardhurave vendore për 3 mujorin e vitit 2024. Konstatohet se rritja e kapaciteteve të krijuara nga njësitë e reja vendore dhe kontrolli më i mirë i shtrirjes territoriale, vazhdojnë të japin efektin pozitiv të rritjes së mbledhshmërisë së taksave lokale duke ndikuar pozitivisht edhe në qëndrueshmërinë financiare të njëjësive të vetëqeverisjes vendore. Ecuria në vite e këtij treguesi reflektohet vizualisht edhe në grafikonin e mëposhtëm:

Grafiku 3: Të ardhurat nga taksat lokale



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)


Taksa mbi pasurinë

Taksa mbi pasurinë, është një burim mjaft i rëndësishëm vendor përmes së cilës njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të zhvillojnë politika vendore nën diskrecionin e plotë të përdorimit. Vitet e fundit në politikat qeveritare, hartimi i metodologjisë së vendosjes së kësaj takse në bazë vlere por dhe ndërtimi i një kadastrë të detajuar mbi pronën, përbëjnë thelbin e reformës mbi këtë burim financimi të njëjësive të vetëqeverisjes vendore.

Duke analizuar në raport me një vit më parë, nga taksa mbi pasurinë janë siguruar rreth 224 milion lekë më shumë të ardhura. Në total për 3 mujorin e vitit 2024 nga taksa mbi pasurinë pushteti

vendor ka siguruar rreth 1,253 milion lekë, duke shënuar një rritje me 22 % në raport me një vit më parë të të ardhurave të kësaj takse. Kjo taksë zë rreth 18 përqind të totalit të të ardhurave të 3 mujorit 2024. Ecuria në vite e taksës mbi pasurinë (ku përfshihen taksa mbi ndërtesën, taksa mbi truallin, taksa mbi tokën dhe taksa mbi transaksionet mbi pasurinë) treguesi reflektohet vizualisht edhe në grafikun e mëposhtëm:

Grafiku 4: Të ardhurat nga taksa mbi pasurinë



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)


Taksa e Biznesit të vogël

Tatimi apo taksa mbi biznesin e vogël është bërë zero pas ndryshimeve fiskale ligjore (ligji nr.112/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”). Nga realizimi faktik gjatë 3 mujorit të parë të vitit 2024, rezulton se nga ky zë janë mbledhur vetëm 18 milion lekë, që zënë vetëm 0.3% të të ardhurave vendore në 3 mujorin 2024, të cilat përfaqësojnë detyrime të paguara me vonesë.

Shpenzimet vendore

Shpenzimet e Pushtetit Vendor janë një tregues i rëndësishëm i procesit të menaxhimit të financave publike në nivel vendor. Ndër vite shpenzimet e pushtetit vendor janë një tregues në rritje të lehtë dhe kjo vjen si pasojë e rritjes së nivelit të shërbimeve dhe funksioneve që pushteti vendor ofron për qytetarët e saj. Shpenzimet e buxhetit vendor për 3 mujorin e parë të vitit 2024, rezulton të jetë realizuar në masën 13,416 milion lekë ose rreth 7.1 përqind më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë ku shpenzimet e buxhetit vendor ishin rreth 12,530 milion lekë. Duke ju referuar të dhënave për shpenzimet e pushtetit vendor për periudhën 3 mujore në vite, do të kemi rezultatet si në grafikun e mëposhtëm:


Grafiku 5: Shpenzimet për pushtetin vendor dhe ritimi i ndryshimit të tyre



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Nga analiza e të dhënave të shpenzimeve sipas zërave përbërës vihet re që zërat e shpenzimeve korente kanë rritje në përgjithësi, tek zërat paga, sigurime, subvencione dhe të tjera vërejmë rritje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ndërsa shpenzimet operative dhe kapitale janë realizuar në terma nominalë më të ulët se 3 mujori 2023. Duke ju referuar të dhënave për shpenzimet e pushtetit vendor për periudhën 3 mujore 2023 dhe 2024 grafikisht situata do të paraqitet si në grafikun e mëposhtëm:

Grafiku 6: Shpenzimet të pushtetit vendor sipas zërave për 3 mujorin 2023-2024



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Më poshtë janë paraqitur në mënyrë të përmblëdhur tabela e ndryshimeve të të ardhurave dhe shpenzimeve në financat publike vendore gjatë 3 mujorit të vitit 2024 dhe 3 mujorit të vitit 2023:

Tabela 1: Të ardhurat dhe shpenzimet faktike të pushtetit vendor sipas natyrës (në milion lekë)

Nr	E M Ë R T I M I	Fakt 3 mujori		Diferenca	
		2024	2023	2024 ndaj 2023 në vlerë	2024 ndaj 2023 në %
I.	Të ardhura nga Pushteti vendor	7,064	5,070	1,994	139.3%
I.1	Taksa mbi pasurinë	1,253	1,029	224	121.8%
I.2	Taksa e biznesit të vogël	18	11	6	156.1%
I.3	Taksat Lokale	5,793	4,030	1,763	143.8%
II.	Shpenzime nga Pushtetit Vendor	13,416	12,530	886	107.1%
II.1	Shpenzime Korente	11,669	10,479	1,190	111.4%
	Personeli	7,858	6,813	1,045	115.3%
	Shpenzime Oper. Mirmbajtje	3,203	3,290	-87	97.4%
	Subvencione	127	74	53	171.7%
	Te tjera	482	302	179	159.4%
II.2	Shpenzime Kapitale	1,747	2,051	-305	85.2%

Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2024)

Shpenzimet e Personelit për 3 mujorin e vitit 2024 përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve totale të njësisë të veqeverisjes vendore me rreth 58.6%. Për këtë periudhë këto shpenzime janë realizuar në masën 7.8 miliard lekë ose rreth 1.2 miliard lekë më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Rritja e këtyre shpenzimeve vjen si rrjedhojë kryesisht nga politika që u zbatua për rritjen e pagave.

Shpenzimet Operative që janë shumë të rëndësishme për mbarëvajtjen dhe ushtrimin e funksioneve, përbëjnë rreth 23.9% të shpenzimeve totale për 3 mujorin e parë të vitit 2024. Këto shpenzime janë realizuar afërsisht në masën 3.2 miliard lekë ose rreth 87 milion lekë më pak se e njëjta periudhë e vitit 2023.

Shpenzimet për subvencione dhe të tjerashpenzime korrente janë shpenzimet që zhvillojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore për të subvencionuar dhe mbuluar funksione të tjera administrative. Në këto kushte nga sa përcaktohet në tabelën më sipër në raport me 3 mujorin e parë të vitit 2023, këto shpenzime për të njëjtën periudhë në vitin 2024 janë rritur me 72% ose 53 milion lekë për zërin subvencione. Ndërkohë, shpenzimet e tjera korrente janë realizuar në masën rreth 482 milion lekë ose rreth 179 milion lekë apo 59% më shumë se 3 mujori i parë i vitit 2023.

Shpenzimet Kapitale janë një zë mjaft i rëndësishëm në buxhetin vendor, për shkak sepse këto shpenzime sjellin në mënyrë direkte dhe indirekte zhvillim ekonomik dhe për rrjedhojë ndikojnë mirëqënien e qytetarëve. Për 3 mujorin e parë 2024 shpenzimet kapitale zënë rreth 13% të shpenzimeve totale dhe janë realizuar afërsisht në masën 1.75 miliard lekë ose rreth 305 milion lekë apo 15% më pak krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023, megjithatë pritshmëria është që ecuria e investimeve të pushtetit vendor të jetë pozitive deri në fund të vitit.